

ROLI I IMBËSHTETJES SOCIALE NË VENDIMMARRJEN E TË RINJËVE PËR
KARRIERË GJATË PERIUdhËS SË PANDEMISË COVID-19

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I ARTEVE NË PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIMI

NGA

DARDANIJE SOPAJ



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË, PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE
KËSHILLIMI
PRISHTINË

KORRIK, 2021

ROLI I MBËSHTETJES SOCIALE NË VENDIMMARRJEN E TË RINJËVE PËR KARRIERË
GJATË PERIUdhËS SË PANDEMISË COVID-19
NGA

DARDANIJE SOPAJ

Mentori: Liridona Jemini-Gashi, Prof. Ass. Dr.

Ka shumë studime që janë bërë për të parë ndikimin e mbështetjes sociale në vendimmarrjen për karrierë. Ngjashëm, edhe në Kosovë, ka studime që për fokus kanë pasur mbështetjen sociale e vendimmarrjen për karrierë. Ndërkaq studimi ynë, është studimi i parë që është kryer në kohën e pandemisë covid-19, dhe ka parë se cili është roli i mbështetjes sociale në vendimmarrjen e të rinjëve kosovarë gjatë kësaj kohe.

Në studim morën pjesë 214 maturantë të shkollave të Kosovës, të cilët janë përzgjedhur përmes metodës joprobabilitare - konveniente; me përgjigje vullnetare; dhe “top bore”. Për mbledhjen e të dhënave janë përdorur pyetësor vetë-raportues, pra studimi ishte kuantitativ. Ndërkaq, për analizimin e këtyre të dhënave është përdorur Paketa Statistikore për Shkenca Sociale – SPSS.

Studimi ynë është përpjekur t’u përgjigjet këtyre pyetjeve hulumtuese:

1. Cili është ndikimi i mbështetjes sociale (mbështetjes familjare, shkollës/mësimdhënësve dhe bashkëmoshatarëve) në vendimmarrjen për karrierë tek të rinjtë, gjatë pandemisë covid-19?
2. Cili faktor (mbështetje familjare, e shkollës dhe bashkëmoshatarëve) ka ndikim më të madh në vendimmarrjen për karrierë tek të rinjtë, gjatë pandemisë covid-19?

3. Sa të rinjë kanë ndryshuar profesionin që kanë menduar ta zgjedhin, për shkak të pandemisë covid-19?

Ndërkaq është hipotetizuar se:

1. Mbështetja sociale (familjare, bashkëmoshatarëve, shkollës/mësimdhënësve) ka ndikim pozitiv signifikant në vendimmarrjen për karrierë tek të rinjtë, gjatë pandemisë covid-19.
2. Mbështetja familjare do të ketë më shumë ndikim në vendimmarrjen për karrierë të adoleshentëve kosovarë, gjatë pandemisë covid-19.

Për t'iu përgjigjur pyetjeve hulumtuese dhe për t'i konfirmuar hipotezat, janë përdorur analiza korrelacionale, regresionale dhe deskriptive. Rezultatet e korrelacionit treguan për ndërlidhje pozitive signifikante të mbështetjes sociale dhe vendimmarrjes për karrierë $r=.449$, $p=.000$, ku mbështetja e prindërve doli të ketë më shumë ndërlidhje me vendimmarrjen për karrierë $r=.431$, $p=.000$. Ndërkaq, analiza regresionale tregoi për ndikim signifikant të mbështetjes sociale në vendimmarrjen për karrierë të të rinjëve Adj. $R^2=.198$, $p=.000$. Po ashtu, mbështetja prindërore doli të jetë faktori më parashikues i vendimmarrjes për karrierë Adj. $R^2=.182$, $p=.000$, pastaj mbështetja e bashkëmoshatarëve Adj. $R^2=.124$, $p=.000$, dhe mbështetja e mësimdhënësve Adj. $R^2=.057$, $p=.000$.

Po ashtu, për të parë se sa maturantë kanë ndërruar profesionin që kanë menduar ta zgjedhin, si pasojë e pandemisë covid-19, është përdorur analiza deskriptive e frekuencës. Rezultatet treguan se 8.9% e pjesëmarrësve kanë ndryshuar profesionin që kanë menduar fillimisht ta zgjedhin, për shkak të pandemisë covid-19. Ata kanë raportuar se pandemia ka ndikuar në procesin e vendimmarrjes për karrierë në këto mënyra: mos marrja e më të mirës nga lëndët shkollore; mos planifikimi i karrierës dhe mosvendosja për profesionin e ardhshëm më herët.

Në anën tjetër, në pyetjen e hapur për vendimmarrje për karrierë, e cila ishte opsionale, disa maturantë kanë raportuar se: kanë vendosur për profesion por nuk e dijnë nëse do të gjejnë një vend pune; që kanë vendosur për profesion por ndjejnë se u duhet mbështetje shtesë; që e gjejnë veten në shumë profesione dhe për këtë arsye nuk mund të vendosin; që u duhen më shumë informata rreth profesioneve; dhe që nuk e dijnë çfarë të studiojnë dhe nuk janë të sigurt për vendimet e tyre.

Duke u bazuar në këto të gjetura, mund të konkludojmë se mbështetja prindërore në veçanti, ajo e shkollës/mësimdhënësve dhe mbështetja e bashkëmoshatarëve kanë ndikim pozitiv në vendimmarrjen për karrierë të të rinjëve dhe janë parashikues i saj. Kjo do të thotë se, sa më shumë që një maturant pranon mbështetje nga prindërit në veçanti, nga shkolla/mësimdhënësit dhe nga bashkëmoshatarët, aq më i vendosur dhe më i sigurt është për përzgjedhje të profesionit.

Mbështetja sociale është faktor kyç për lehtësimin e situatave të krizave, të tilla si pandemia covid-19, e po ashtu faktor me ndikim edhe për vendimmarrje gjatë kësaj periudhe. Prindërit, shkolla dhe bashkëmoshatarët duhet të dijnë për rëndësinë e kësaj mbështetjeje në mënyrë që të rinjtë tanë të kenë më të lehtë orientimin për karrierë. Andaj, rekomandohet që të ofrohen shërbimet e orientimit në karrierë për maturantët e shkollave të mesme të vendit tonë, në mënyrë që ata të jenë të informuar për secilin profesion. Në anën tjetër, sa i përket mbështetjes familjare në veçanti, asaj të mësimdhënësve dhe bashkëmoshatarëve, rekomandohet që të organizohen projekte përmes së cilave do t'u shpjegohej roli dhe ndikimi pozitiv që ata mund të kenë në procesin e vendimmarrjes për karrierë, sidomos në situata krize, të tilla si pandemia covid-19.